

Ferdinand Samaxhi: Qerbelaja, mësim aktual historie

Qerbelaja... Homazh ngadhënjyjes i njerëzimit për liri e demokraci...



Ferdinand Samaxhi "Mjeshtër i Madh"

NË VEND TË EPILOGUT...

Fundgushti kujton histori... Qerbelaja. Gjakderdhje. 72 dëshmorë. Prijës heronj, Imam Hysen, Abaz Ali. Ujdhësë arabike. Sundim jeziterësh, mavish. Kohë diktaturash famëkeqe. Mynxyrë jete. Gllabërim shpirtëror zotash. Opskurantizëm i gjallë. Mjegullnajë e zezë shpirtërore. Egërsi barbare. Luftëra të egra. Përgjakje. Histori. Qerbelaja. Epope ngadhënjyese lirie, emancipimi njerëzor.

Engjell që m'u qase pranë, Nga i madhi Zot, Pse më rrëfen Qerbelanë? A do të derth lot?

Shekulli VII. Qerbelaja hyri në histori si një epope për liri, demokraci, emancipim njerëzor i kombit arab në ujdhësën e tij.

Këtu do të nisë historia për demokraci e kombit arab, nën ujdhësën e tyre arabike.

Diktaturë famëkeqe e Jezitit të Mavisë. Dypushtet, administrativ-politik, fetar i tij. Ekstrema kanibale të kohës. Foshnja thejor po të lindte femër apo propojë e gjallë. Imam Hyseni do të lindte, luftojë si luftëtar, prijës, strateg për emancipim njerëzor. Njerëzit, ende në padituri, të mos besojnë në vullnetet zotash e idhujtarësh, por t'i drejtohen një Zoti të vetëm, Allahut të madh. Imam Hyseni do të luftojë për të drejta themelore të jetës. Femra të jetojë, gëzojë jetën e saj, njëjloj si krijesë e barabartë.

Që në fëmijëri, Imam Hyseni, krah për krah të atit, Imam Aliut, do të luftojë në luftën e Xhemelit, Sifinit dhe Nehrevanit.

Islami, besim si gjithë të tjerët, i barabartë mes tyre. Të gjithë të besojmë, jo zotave, një Zoti. Imam Hyseni do të evokojë për kohën tek arabët një shpresë. Shpresë, që do të posedojë besimin në një Zot të drejtë hyjnore, kundër diktaturës së Jezitit të Mavisë, kanibalizmit të jetës, ujdhësë arabike.

Së bashku më vëllanë e tij, Imam Hasanin, gjithë Ehli-Bejtin, Imam Hyseni përjeton ndodhi të shumta në Medinë, ku lufta ishte më e ndjeshme për mbrojtjen e islamit. Ata ishin në ballë si strateg të përhapjes, mbrojtjes së tij, besimit në një Zot të vetëm.

Politika obskurantiste e diktaturës së Jezitit Mbret, kanibalizmi që përjetojnë arabët nuk do të pranohet kurrë nga shenjtori Imam Hyseni. Medina dhe më vonë Meka do të bëhen për të qëndrore dhe vendi i banimit të tij, ku ai do të vazhdojë luftën e tij më shumë dhe në kushte më të vështira. Duke qenë se ujdhesa arabike përjetonte dhe ishte në prologun e ndryshimeve të mëdha të mosbesimit të idhujtarive dhe fillimit të një besimi të vetëm, islamit, që shihet si një dritë për jetën e njerëzve; Ai do të evokojë dhe



Shefi i kabinetit të Presidentit të Republikës, z. Arben Cici, uron Kryegjyshin Botëror, shenjtërinë e tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj: Qoftë e bekuar kjo ditë, mbarësi për të gjithë shqiptarët!




Ambasadore dhe personalitete të Kishës Ortodokse, në pritjen zyrtare të Ditës së Ashures



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi: Qerbelaja, epope ngadhënjyese e historisë së njerëzimit për liri, demokraci, emancipim të shoqërisë njerëzore, mësim aktual për kohën...

mëkojë në të gjithë arabët islamit, si besim që duhet përfuar dhe se kjo do të arrihet vetëm kundër diktaturës së kohës, që ishte mishërim i obskurantizmit dhe idhujtarive, Jezitit të Mavisë. Kufa përjetonte më shumë ndryshime që kishin lind në vendet arabe dhe që banorët e saj ishin më të prirur për këto ndryshime. Imam Hyseni, duke qenë se në Kufë, ziente lufta midis besimtarëve dhe jobesimtarëve, pranoi kërkesat e shumta të banorëve të Kufës dhe sheitëve të Irakut, që të vinte e të vihej në krye të tyre për të përmbytur diktaturën. Dërgimi i letrave, pranimi i kërkesave të tyre, marrjes së besës nga banorët e Kufës dhe të Basras, nëpërmjet Myslym Akilit, përfaqësuesit të denjë të tij, në ditën e tetë të muajit Dhahixhe të vitit Hixhri la Mekën dhe iku në drejtim të Irakut.

O moj fushë e Qerbelasë!
Që më rri ndër sy,
Plot me gjak t' Ali-Abasë,
Vallë ç'është' ay?
Hyseni desh njerëzinë
Dhe për të u vra
Për të shpëtuar njerinë
Ra në Qerbelaja.



Apostull i pavdekshëm, hyjnor i Zotit, legjenda e bektashizmit, shenjtori Dede Reshat Bardhi, gjithmonë do thërrasë në Zot njerëzit

t'u drejtohej banorëve të Kufës me masazh paqeje: "O ju kombi mundimdhënës! Nuk keni frikë nga Perëndia, e cila popullin e Firaunit e mbyti në ujërat e Nilit dhe ngatërstarët e Filit i vrau me gurë me anë të zogje Ebalit? A keni frikë prej atij Zoti, që zhdukua malësorët e popullit Lut, ndërsa kundërshtarët e Profetit Nuh i bëri të vuajnë? O ju gjakpirës! Në qoftë se besoni në atë Perëndi dhe te Profeti që është gjyshti im, hiqni dorë nga këto të këqija që po bëni. Mendoni fundin e jetës suaj. Pra, jepuni fund veprave të këqija, duke më lënë të lirë të shkoj bashkë me fëmijët dhe gratë nga ana e Arabisë ose Rumisë e t'ju liroj juve viset e Arabisë dhe tokën e Hixhasit e të Ebalit. Në qoftë se nuk do t'i pranoni këto fjalë dhe në qoftë se medoemos doni të luftoni me mua, atëherë të paktën dilni një nga një në fushën e luftës..."

*Më ç'do an' i ka rrethuar
Kombi faqezi,
Komb'i lik i mallëkuar,
Posi mizëri!*
Të rrethuar, të tradhtuar pabesisht, falangat e Jezitit të Mavisë, përsëri çnjerëzisht shkelin ligjet e luftës. I vetmi burim jete, uji, për të mbijetuar, Eufirati, helmohet nga mizoritë e Jezitit të Mavisë. Luftëtarët e Qerbelasë, për 10 ditë me radhë luftojnë pa vënë bulën e ujit në buzë, deri në pikën e fundit të gjakut, me prirjesin e tyre Imam Hysenin.

*Ujë ua kanë prerë
Janë në shtrëngim,
Si të varfër e të mjerë.
Në zi, në hidhërim
Frat, o more lum'i shkretë
Mos këndo pa qaj,
Derth lot e rënko për jetë,...*

Siç tregon legjenda e shkruan historia, Abaz Aliu, heroi i luftës së Qerbelasë, duke parë buzët e thara të foshnjave, lotët e tyre, si tribun hero, do të çajë rrethimin për t'i mëkuar ato.

*Nëpër mest të ushtrisë
Të armikut shkon,
Shërbtor' e njerëzisë
Shigjeta s'e çpon
Është nder'i trimërisë
Zoti e mburon.
Ç'ikën ay kal'i shkretë,
Mi dhë nuk shkel
Nga potkonjtë q'ikën shpejtë
Zjar e flak'i del!*

Abaz Aliu, si shenjtor me një kacak për të mëkuar foshnjat me ujë, erdhi në Dodonë, tempullin e lashtë të saj, të Jupitërit Thesprot, siç thotë Eskili, babai i historiografisë së vjetër





Kryegjyshi Botëror, shenjtëria e tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, vazhdues i denjë i rrugës së Dede Reshatit: Zotin e kemi gjithmonë pranë



Abaz Ali, heroi i luftës së Qerbelasë: Ç'është ai që shkon kaluar, me dy-tre foshnja në duar, është Abaz Ali. Abaz Aliu zo Tomorr, edhe erdhi afër nesh...



Më ç'do an' i ka rrethuar Kombi faqezi, Komb'i lik i mallëkuar, Posi mizëri!

Qerbelaja, pabesi, tradhti e përgjakshme...



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, uron Kryegjyshin Botëror në Ditën e Ashures



Kryetari i KMSH-së, hërësia e tij e naltë, H. Bujar Spahiu dhe nënkryetarja e bashkisë, Anisa Ruseti, vizitojnë Kryegjyshin Botëror me rastin e Ditës së Ashures dhe e urojnë atë



helene, në veprën e tij "Prometeu i lidhur", shekulli V p.e.s. fq.800: "... Kur ju të keni arritur në tokën e molosëve të Dodonës së Sipërme, ka një Orakull të Jupiterit Thesprot ...".

Në librin VI, VII, Eskili shprehet se tempulli i Dodonës gjendet në majë të një mali të lartë, që është Tomorri i sotëm, që do të marrë pas ardhjes së tij në këtë vend të shenjtë emrin e tij, që quhet sot: Tempulli i Dodonës së lashtë Pel-lazgjike, të tokës së molosëve, Orakulli i Zeusit, tempulli i sotëm Abaz Ali.

Ç'është' ay që shkon kaluar, Ikën si iveriu, Me dy-tri foshnja në duar? Është' Abas-Aliu! I ka marrë etja shumë, E qajnë me lot!

Abaz Aliu erdhi në Tomorr, në tempullin e lashtë të Jupiterit Thesprot, për të mëkruar foshnjat, për të shenjtëruar në tej këtë vend të shenjtë.

Abaz Aliu zo' Tomorë, Erdhi afër nesh, Shqipëria s'mbet e gjorë, Se Zoti, atë'e desh.

MARTIRIZIMI I IMAM HYSENIT...

20 tetor 680. Në Qerbelā, në Irak, ra heroi. Fusha u skuq. Gjaku u derdh e u shkrua historia. Diktatura u mund. Triumfoi dhe vjimmësoi familja e Ehli-Bejtit.

O moj fushë e Qerbelasë! Që më rri ndër sy, Plot me gjak t' Ali-Abasë, Vallë ç'është' ay? Hyseni desh njerëzinë Dhe për të u vra Për të shpëtuar njerinë Ra në Qerbelā.

MATEMI, AGJËRIM SHPIRTËTOR, PA UJË, SI LUFTËTARËT E QERBELASË NË BETEJË...

Zemrat njerëzore të besimtarëve ende lojtojnë për gjakun e heronjve, që ranë dhe skuqën Qerbelanë. Me sytë e zemrës së tyre, ende vuajnë për gjakun e trimave që u derdh në emër të një lirie, në emër të një jete.

Gjatë 10 ditëve, besimtarët bektashianë myslimanë, alevianë, kudo që ndodhen në botë, në më shumë se 31 vende ku janë dhe gjenden veprat e kultit të tyre, teqetë, tyrbet, mekame, si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Greqi, Bullgari, Rumani, Hungari, Egjipt, Turqi, Irak, Iran, Afganistan, Azerbajxhan, Turkmenistan, Tashkikistan, Pakistan, Rusi, Kinë, ShBA, Kanada, Australi, Francë, Belgjikë, Holandë, Zvicër etj., përkujtojnë në shenjë zie 72 luftëtarët, dëshmorët të rënë, heronj në Qerbelā, me në krye prijësin e tyre, shen-



Personalitete të diplomacisë së jashtme, ambasadorë dhe përfaqësues të tjerë urojnë Kryegjyshin me rastin e Ditës së Ashures

jtorin Imam Hyseni.

Ashtu si dëshmorët e Qerbelasë që luftuan për 10 ditë në zjarrin përvëlues të shkretëtirës pa bulën e ujit në gojë, duke derdhur gjakun e tyre, duke rënë heroikisht në fushën e betejës në Qerbelā, në këto 10 ditë, për përpshirje të tyre, bektashianët në të gjithë botën mbajnë zi për ta, mbajnë matem, nuk pinë ujë.

Këto ditë, bektashinjët e të tjerë mbledhen në teqetë e ndryshme, ku udhërrëfyesit (klerikët) lexojnë me zë të lartë "Hadikanë",

bëjnë ritualin e përditshëm, duke përkujtuar vuajtjet e profetëve, ngjarjen tragjike të Qerbelasë, luftën, sakrificën, vetëfljimin e tyre për të fituar liritë e shenja të jetës, në shërbim për të mirë të njerëzisë, duke predikuar rrugën e drejtësisë, paqes, vëllazërisë, përsosmërisë shpirtërore, njerëzore.

Nata e parë u kushtohet vuajtjeve të profetëve: Adem, Nuh, Ibrahim, Jusuf, Musa dhe Krishtit. Të dytën për Profetin Muhamed (a.s); të tretën për Imam Aliun; të katërtën për Imam Hasanin; të pestën për lindjen dhe jetën e Imam Hysenit; të gjashtën për ikjen e tij nga Medina në Mekë; të shtatën për vrasjen e Myslym Akilit dhe dy djemve të tij, Myftarin, Ibrahimin; të tetën për nisjen e Imam Hysenit për në Kufë; të nëntën për mbërritjen e tij në Qerbelā; natën e dhjetë për martirizimin e tij dhe të dëshmorëve të tjerë që derdhën gjak, ranë heroikisht dhe shkuan në Ahiret(Parajsë), buzëtharë, buzëçarë nga etja.

ASHURJA, VENERACION PËR LUFTËTARËT E QERBELASË

Ashurja, përfundim i zisë, përpshirje lavdie për dëshmorët e Qerbelasë.

Dhjetë ditë, gjithandej liturgji. Mjediset bektashiane, teqe, tyrbë, mekame. Besimtarët pinë ujin e jetës, sherbetin. Të dhjetën ditë, ashurja në zjarr. Gjithë natën, deri në agun e ditës së nesërme. Dita e dhjetë, ashure për përpshirje të luftëtarëve të Qerbelasë, përkujtim i jetës dhe i ushqimit të tyre, të cilin e gatun me mbetjet e gjërave që

patën me vete gjatë udhëtimit në Kufā. Grurë, qiqra, soji, fasule, bathë, misër, fiq, rrush të thatë, mollë, arra, mjalte, mushk, kanellë etj., që përbëjnë rreth 40 përbërës të prodhuar nga toka.

Te lindja, siç ndodh me embrionin e grurit, shumimin e tij, bektashinjët shohin filozofinë e vazhdimësisë, të familjes së Ehli-Bejtit.

Pas liturgjisë, kryerjes së ritualeve, populli, besimtarët bëjnë vizita. Përkujtojnë me veneration heroinë e Qerbelasë, Imam Hysenin dhe 72 dëshmorët e tij që u vetëfljjuan, gjer në sakrificën njerëzore, sublimë, për mbrojtjen e idealeve të jetës. Dita e dhjetë, ceremoni kremtimi për përpshirje, Dita e Ashures.

Kryegjyshi Botëror, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, drejton ceremonitë për të gjithë besimtarët e botës. Mesazhi i tij: "Qerbelaja, epope e luftës së njerëzimit për liri, demokraci, prosperitet dhe emancipim njerëzor".



Shkrimtarë, personalitete të letërsisë, profesorë, publicistë, poetë kumtojnë poezi dhe thurin vargje për rilindësin e madh, Naim Frashëri, pranë bustit të tij në selinë e Kryegjyshitës Botërore



Organizimi i ceremonisë së luftës së Qerbelasë, rënies së 72 dëshmorëve me Imam Hysenin dhe Abaz Alinë në fushën e betejës, në selinë e Kryegjyshitës Botërore Bektashiane në kushtet e pandemisë